

L I G J
Nr. 8848, datë 19.12.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8437, DATË 28.12.1998 “PËR
AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8507, DATË
7.7.1999, NR.8595, DATË 6.4.2000 DHE NR. 8716, DATË 15.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë“, ndryshuar me ligjet nr.8507, datë 7.7.1999; nr. 8595, datë 6.4.2000 dhe nr.8716, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1. Pika “C” ndryshohet si më poshtë: | |
| “C. Pije joalkoolike, freskuese e të tjera | 3 000 lekë për 1000 litra”. |
| 2. Pika “D” ndryshohet si më poshtë: | |
| “D. Kafe | |
| - Kafe e papjekur | 33 000 lekë për 1000 kg |
| - Kafe e pjekur e bluar ose jo | 78 000 lekë për 1000 kg.”. |

Neni 2

Pas nenit 3 shtohet 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Importuesit, prodhuesit dhe tregtarët me shumicë të mallrave me akcizë, regjistrohen si tregtarë të mallrave me akcizë në organet tatimore.”.

Neni 3

Pas paragrafit të parë të nenit 4, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për birrën e prodhuar në vend, llogaritja e akcizës bëhet duke zbatuar mbi sasinë e birrës së prodhuar dhe të deklaruar, përqindjen e akcizës së përcaktuar në nenin 3 të ligjit “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”. Sasia e birrës së deklaruar korrigjohet në rritje, në përpjesëtim të barabartë me masën e tejkalimit të kufirit teknik maksimal të lejueshën të rezes së maltos së përdorur mbi 20 kg për 100 litra birrë të prodhuar.

Tatimpaguesit e regjistruar për prodhimin e birrës ose për importimin dhe tregtimin e maltos, si lëndë e parë për prodhimin e birrës, detyrohen të paguajnë 294 lekë akcizë për kilogram malto të llogaritur në rastet e shitjes së maltos personave të paregjistruar për prodhimin e birrës ose të përdorimit të saj për qëllime të tjera.”.

Neni 4

Shkronja “a” e nenit 5 ndryshohet si më poshtë:

“a) Për mallrat e prodhuara në vend,, kur detyrimi nuk paguhet nëpërmjet blerjes së pullës

fiskale, akciza llogaritet në çastin e lëvizjes së mallrave nga vendi i prodhimit, dhe deklarohet e paguhet për periudhën 1-15 të muajit brenda 20 të muajit, ndërsa për periudhën 1-31 të muajit deri më datën 5 të muajit pasardhës.”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Akciza paguhet për importimin dhe prodhimin brenda vendit të mallrave që i nënshtrohen akcizës. Akciza paguhet gjithashtu edhe për mallrat e prodhuara në vend, të cilat prodhohen me lëndë të importuara, që i nënshtrohen akcizës në çastin e importimit.

Importuesit, prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të mallrave, që i nënshtrohen akcizës, për të gjitha shitjet që kryejnë, detyrohen të identifikojnë në faturat tatimore të shitjes emrin, NIPT-in dhe kodin fiskal të tatimpaguesit blerës.”.

Neni 6

Pas pikës 4 të nenit 9 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, akciza e të cilave paguhet nëpërmjet pullave fiskale, pa blerë këto pulla.

6. Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në organet tatimore.

7. Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave të tatueshme me akcizë, duke njohur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar.”.

Neni 7

Në nenin 10 shtohen paragrafët si më poshtë:

“ – Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, pa pullat fiskale, në rastin kur akciza e tyre paguhet nëpërmjet pullave fiskale, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në organet tatimore, përveç pagimit të shumës së akcizës që duhej paguar, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave që i nënshtrohen akcizës, duke ditur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.”.

Neni 8

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Për firot, që ndodhin gjatë procesit të përpunimit dhe prodhimit të produkteve, zbritja lejohet në kufijtë e firove teknikisht të pranueshme, të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe ministria përkatëse.”.

Neni 9

Ky ligj hyn 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3207, datë 26.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani